



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:226089

Datë: 30.01.2025

Numri i dokumentit: 06782432

P.nr.292/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Besart Prishtina, në çështjen penale kundër të pandehurve E.R. me vendbanim në rrugën “...” në Vushtrri, me mbrojtësin sipas autorizimit Av. Kastriot Feka me seli të zyrës në Prishtinë për shkak të veprës penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par.1 i KPRK-së si dhe të pandehurit të parë dhe të pandehurit I.SH. me vendbanim në rrugën “...”, në Vushtrri me mbrojtësin e caktuar sipas detyrës zyrtare Av. Naser Azemi, që të dy për shkak të veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.4, lidhur me par. 2 dhe 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Mitrovicë, PP.nr.1647/2023, të datës 23.10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë, publik me datë 23.01.2025, në praninë e Prokurorit të shtetit Shaqir Sedolli, të pandehurit të parë E.R., mbrojtësit të tij Av. Kastriot Feka, të pandehurit të dytë I.SH., mbrojtësit të tij Av. Naser Azemi, pas shpalljes së aktgjykimit me datë 24.01.2025, më datë 30.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

NDAJ TË PANDEHURVE:

I. E.R., nga i ati N..., e ëma N..., e vajzërisë P..., data e lindjes... në Mitrovicë, tani me vendbanim në rr. ...” në Vushtrri, me numër personal ..., pronar i Restorantit “...”, ka të kryer shkollën mesme, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pagjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 07.10.2023, rreth orës 18:15, në magjistralen Vushtrri – Mitrovicë, në fshatin Dobërllukë, dhen ë rrugën “Haxhi Zeka” dhe “M.B.”, drejton automjetin në gjendje të dehur dhe

shkakton aksident trafiku, në atë mënyrë që, i njëjti ka drejtuar automjetin e tipit “Mercedes”, me targa 01-212-QE, dhe pasi ka tejkaluar në vijë të plotë, një automjet i policisë i ka dhënë shenjë që të ndalet, mirëpo i pandehuri ka vazhduar duke e rritur shpejtësinë e automjetit dhe gjatë ikjes ka shkaktuar dy aksidente trafiku, duke i goditë dy automjete duke përfshirë edhe automjetin e Policisë së Kosovës, pas ndaljes nga policia është konstatuar se i njëjti ka vozitë në gjendje të dehur me 0.75mg/l në gjak.

- Me këtë ka kryer veprën penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 31, 38, 39, 40, 42, 46, 47, 48, 69, 70, dhe neni 315 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të KPRK-së si dhe neni 19. 270, 364, 449, 452 dhe 462 të KPPK-së, të pandehurin, e

GJYKON

Me DËNIM ME GJOBË, në shumë njëmijë e tetëqind (1,800.00) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mundet që t’u paguaj gjobën, gjykata, të njëjtën do t’ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim.

Koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 07.10.2023 deri me datën 30.11.2023 të pandehurit i është llogaritur me rastin e shqiptimit të dënimit.

Të pandehurit të parë i është ndaluar drejtimi i automjetit për një periudhë në kohëzgjatje prej një (1) viti dhe atë nga dita kur vendimi merre formën e prerë.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor t’u paguaj shumën prej njëqind (100.00) euro.

Detyrohet i pandehuri që në emër të fondit për programin e kompensimit të viktimave të krimit t’u paguaj shumën prej njëzet (20.00) euro.

Të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimin, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

II.

Të akuzuarit:

I. E.R., nga i ati N..., e ëma N..1, e vajzërisë P..., i data e lindjes... në Mitrovicë, tani me vendbanim në rr. në Vushtrri, me numër personal ..., pronar i Restorantit "...", ka të kryer shkollën mesme, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pagjykuar.

II. I.SH., nga i ati M..., e ëma R..., e vajzërisë D..., data e lindjes..., në Mitrovicë, tani me vendbanim në rr. "...", në Vushtrri, me numër personal ..., punon herë pas here si shankist, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, më parë i pagjykuar.

Në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par. 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje: KPPK).

LIROHEN NGA AKUZA

SEPSE: Me datën 07.10.2023, rreth orës 18:15, në Vushtrri, në rr. "M.B.", të pandehurit, me dashje, në bashkëkryerje sulmojnë personat zyrtar, ashtu që, të njëjtit pas ndjekjes policore, me ti ndaluar policia, kur iu janë afruar, i pandehuri i parë E.R. e ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin – zyrtarin policor D.I. duke e goditë me shkelma në këmbën e djathtë, e më pas edhe me grushte në fytyrë, me ç 'rast i shkakton lëndime trupore, ndërsa i pandehuri i dytë I.SH., me një shishe qelqi – shishe të birrës ka tentuar t'a godet zyrtarin policor R.K. dhe e ka sulmuar me shkelma zyrtarin Fisnik Vërbovci.

- Me këtë në bashkëkryerje kishin për të kryer veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402, par.4, lidhur me par. 2 dhe 1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Të dëmtuarit D.I. dhe R.K. kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Shpenzimet e procedurës për pjesën liruese bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.nr.1647/2023, të datës 23.10.2023, kundër të pandehurit me të cilin ka akuzuar të pandehurit E.R. me vendbanim në rrugën "...", në Vushtrri, me mbrojtësin sipas autorizimit Av. Kastriot Feka me seli të zyrës në Prishtinë për shkak të veprës penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par.1 i KPRK-së si dhe të pandehurit të parë dhe të pandehurit I.SH. me vendbanim në rrugën "...", në Vushtrri me mbrojtësin e caktuar sipas detyrës zyrtare Av. Naser Azemi, që të dy për shkak të veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.4 lidhur me par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Gjykata, me datën 31.10.2023 ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin i pandehuri i parë e ka pranuar fajësinë sa i përket pikës I të aktakuzës, dhe atë për veprën penale

Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par.1 i KPRK-së. Të dy të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm sa i përket pikës II të dispozitivit të aktakuzës, për veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.4 lidhur me par. 2 dhe 1 të KPRK-së. Të njëjtit janë udhëzuar që brenda 30 ditësh mund të paraqesin kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhje të aktakuzës.

Mbrojtësi i të pandehurit të parë dhe mbrojtësi i të pandehurit të dytë kanë paraqitur kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës, ndërsa Prokurori i shtetit ka paraqitur përgjigje në kërkesat e mbrojtësve. Gjykata me aktvendimin P.nr.292/23, të datës 05.02.2024 ka refuzuar kërkesat e mbrojtësve si të pabazuara.

Mbrojtësit e të pandehurve, kundër aktvendimit të kësaj gjykate P.nr.292/23, të datës 05.02.2024, me të cilin janë refuzuar kërkesat e tyre për hedhjen e aktakuzës, kanë paraqitur ankesa. Në anën tjetër Prokuroria e Shtetit ka paraqitur përgjigje në ankesa, ku ka propozuar që ankesat mbrojtësve të të pandehurve të refuzohen si të pabazuara. Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN.nr.424/2024, të datës 26.03.2024, ka refuzuar ankesat e mbrojtësve të të pandehurve si të pabazuara.

Gjykata me datën 14.11.2024, 21.11.2024 dhe 23.01.2025 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, ku të pandehurit nuk e kanë pranuar fajësinë, dhe pas kësaj janë dhënë fjalët hyrëse, është bërë administrimi i provave dhe fund janë dhënë fjalët përfundimtare të palëve.

Pretendimet e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën hyrëse ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor në çështjen penale nën shenjen e identifikimit PP.II.nr.1647/23 të dt.23.10.2023 përtej dyshimit të bazuar mirë do të vërtetohet se të pandehurit E.R. dhe I.SH. me datë 07.10.2023, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.4 lidhur me par.2 dhe 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës do të vërtetohet nga provat materiale dhe personale dhe atë nga i dëmtuari i cili do të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit D.I., ku i njëjti do të përshkruaje në tërësi ngjarjen e datës 07.10.2023, ku ndër të tjera do të theksojë se automjeti i tipi mercedes me targa të regjistrimit 01-212-QE, ngjyrë e gjelbër, i kishte tejkalaruar automjetin e policisë dhe automjetet tjera në vijë të plotë, kështu që i njëjti kishte rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në trafik dhe pasi që kanë arritur që ta lokalizojnë, së bashku me rreshterin B.A., pasi kanë dalë nga automjeti nga ku kishte dalë edhe i pandehuri E.R., dhe me këtë rast e kishte godit me shqelma në këmbën e djathtë dhe me grushtin e dorës së djathtë – boksin e kishte goditur në fytyrë në syrin e djathtë po ashtu do të dëshmojë si i njëjti gjatë arrestimit ka qenë agresiv duke i sharë dhe duke ju thënë fjalët “largohuni çka keni që jeni bo ma të zi se shkijet, keni me pa çka ko me ju bo juve”, po ashtu edhe pasagjeri, i pandehuri I.SH. sapo kishte dalë nga vetura ka tentuar ti ndihmojë shokut të tij në këtë rast E.R., ky përshkrim të gjendjes faktike është dhënë edhe nga i dëmtuari tjetër R.K. i cili po ashtu do të dëshmojë se si ka ardhur ngjarja e asaj dite, po ashtu edhe nga dëshmitarët B.A., F.V. dhe F.C., të gjitha këta zyrtarë policorë të cilët kanë qenë të pranishëm, do të dëshmojnë gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor

tërë rrjedhën e rastit, e po ashtu dëshmitari H.H. të cilit i është goditur automjeti, i njëjti do të dëshmojë se me datë 07.10.2023 rreth orës 18:00, kishte qenë në veturën e tij, në rr. “Haxhi Zeka” në drejtim të rr. “Skënderbeu”, ku e ka parë një veturë e cila ka lëvizur me shpejtësi të madhe dhe e kishte goditur në anën e majtë të veturës të tij. Ndërsa nga ekspertiza mjeko ligjore e datës 13.10.2023 do të vërtetohet se i dëmtuari D.I. ka pësuar rëndime të lehta trupore të përshkuara si në këtë akt ekspertim mjeko ligjor, gjithashtu nga foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës shihet vendi, automjetet dhe i dëmtuari D.I. dhe lëndimet të cilat i ka marrë në fytyrë nga dy të pandehurit. Pas administrimit të të gjitha provave në tërësi do të vërtetohet fajësia e të pandehurve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar gjate këtij shqyrtimi gjyqësor ne çështjen penale nën shenjen e identifikimit PP.II.1647/23, përtej dyshimit te bazuar mirë, është vërtetuar se të pandehurit E.R. dhe I.SH. në bashkëkryerje kane kryer veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.4 e lidhur me par.2 dhe 1 dhe nenin 31 të KPRK-së. Kjo është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit D.I., ku nga kjo dëshmi vërtetohet se i pandehuri E.R. pasi që i kishte bere rezistence policisë gjate arrestimit, i njëjti edhe e kishte sulmuar te dëmtuarin duke e goditur ne anën e djathte te fytyrës, ku nga kjo goditje ka pësuar lëndime trupore, te cilat janë vërtetuar nga raporti i ekspertizës mjeko ligjore, ku ne këtë raport këto lëndime janë kualifikuar si lëndime te lehta trupore dhe atë ndrydhje e indeve te regjionit te mollëzës te faqes së djathtë dhe regjionit te nyjës se zogut te këmbës. Poashtu nga deklarata e dëshmitarit B.A. është vërtetuar se i dëmtuari ishte goditur me shkelma nga i pandehuri Eroll si dhe ne fytyre ne anën e djathte dhe se i njëjti e kishte parë momentin e goditjes, po ashtu nga dëshmia e tij vërtetohet edhe fakti se nga video incizimi i cili gjendet ne shkresat e lendes, shihet vetëm momenti i pare i kontaktit me te pandehurin, mirëpo gjate kohës sa ka qene duke u prangosur i njëjti e ka kryer sulmin ndaj te dëmtuarit, ku edhe nga fotografitë që gjenden ne shkresat e lendes vërtetohen shenjat e lëndimeve te marrja ne fytyrën e te dëmtuarit te shkaktuara nga ana e te pandehurit Eroll.

Po ashtu edhe nga procesverbali për alkool testin vërtetohet se te njëjtit me datë 07.10.2023, kane qenë në gjendje të dehur. Gjithashtu ne tërësi është vërtetuar se edhe i pandehuri I.SH. ka tentuar që të godas R.K.n si dhe i njëjti ne vazhdimësi ka rezistuar, kjo është vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarit F.V., ashtu që nga dëshmia e dëshmitarit R.K. vërtetohet se i njëjti ka kërkuar disa here që të lëshoj i pandehuri shishen ne toke, por që i njëjti nuk iu ka bindur këtyre urdhrave, ndërsa nga dëshmia e dëshmitarit F.V. është vërtetuar se i njëjti ka qenë shume agresiv ne momentin e arrestimit, ka shqelmuar vazhdimisht, e gjithashtu nga dëshmia e tij është vërtetuar se kolegu i tij ishte goditur ne fytyre dhe se i njëjti e kishte dërguar ne tretman mjekësor. Ndërsa nëse i referohemi video incizimit dhe video incizimit që gjate kësaj seance u tregua nga ana e mbrojtjes, shihet momenti kur është ndalur automjeti, edhe pse pamja është shume e turbullt, nuk mund te shihen as fytyrat e personave, mirëpo ne një moment mund te shihet rezistimi i te pandehurit I.SH. ku edhe i njëjti tenton te gjuaj me grusht, se paku është vlerësimi im ky ne raport me atë që e pash, ndonëse imazhet janë te turbullta. Andaj pas vlerësimit te gjithë këtyre provave vërtetohet fajësia e te pandehurve, për çka prokurori i shtetit i propozon gjykatës që të pandehurit te i shpall fajtor dhe te i dënoj sipas ligjit, ashtu që gjate matjes së dënimit, llojit dhe lartësisë se tij, te merr parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ashtu që si rrethane rënduese te

merr parasysh shkallen e larte te dashjes ne drejtim te kryerjes se veprës penale, faktin se te njëjtit nuk i janë bindur urdhrave te zyrtareve policore dhe gjate gjithë kohës kane rezistuar, e po ashtu edhe si rrethane rënduese te merret parasysh se ne kohen kur ka ndodhur ky rast te njëjtit kane qenë në gjendje te dehur- alkoolizuar. Gjithashtu gjykatës i propozoj që ta pajiset me certifikatën e evidencës penale dhe varësisht se çka rezulton nga e njëjta te merret si rrethane renduese apo lehtësuese. Ndërsa rrethana te tjera lehtësuese prokurori i shtetit nuk gjeti.

I dëmtuari i parë D.I. dhe i dëmtuari i dytë kanë deklaruar se mbështesin deklarinimin e prokurorit të shtetit dhe se nuk kërkojnë kompensim dëmi.

Mbrojtësi i të pandehurit të parë Av. Kastriot Feka në fjalën hyrëse ka deklaruar se e kundërshtojmë në tërësi si të pabazuar këtë aktakuzë, pasi siç e kemi paraqitur edhe kundërshtimin e provave dhe kërkesës për hedhje të aktakuzës, e njëjta sa i përket të mbrojturit tim nuk qëndron, pasi që dëshmohet edhe nga deklaratat e dy të akuzuarve e po ashtu edhe nga vetë deklarimi i zyrtarëve policor, në cilësi të dëshmitarëve, shihet se të njëjtit kanë qenë në gjendje jo stabile apo jo të qëndrueshme për t'i sulmuar zyrtaret policorë, e gjitha kjo dëshmohet me një video incizim të cilin e kemi paraqitur pranë kësaj gjykate me rastin e parashtrimin të kundërshtimit, ku shihet se i mbrojturi im është në gjendje të dehur dhe vetëm del nga vetura dhe dhunë apo vepra penale është kryer nga zyrtari policor ndaj të mbrojturit tim, pasi që i njëjti pa e provokuar sulmi, pa sulmuar askënd, sulmohet në mënyrë brutale ku pëson lëndime të lehta trupore, të cilat dëshmohen edhe me ekspertizën mjekësore e po ashtu edhe me foto të të mbrojturit tim. Konsiderojmë se aktakuza sa i përket dispozitivit II është e pa qëndrueshme, e pa bazuar dhe i mbrojturi im për këtë pikë është i pafajshëm.

I njëjti në fjalën përfundimtare të cilën e ka dorëzuar me shkrim ndër të tjera ka theksuar nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402, par.4, lidhur me par. 2 dhe 1 dhe nenin 31 të KPRK-së. Tutje ka shtuar se deklaratat e dëshmitarëve dhe të dëmtuarit janë të paqëndrueshme dhe të pabazuar për faktin se nga ajo çfarë kanë deklaruar të njëjtit, nuk përkojnë me gjendjen faktike real dhe m video incizimet që i kemi paraqitur gjykatës Deklarimet e të njëjtëve janë edhe kundërthënëse kur të njëjtit kanë deklaruar se i pandehuri ka qenë në gjendje të dehur dhe i paaftë për të ndërmarrë ndonjë veprim, e në të njëjtën kohë kanë deklaruar se i pandehuri ka qenë rezistues duke e goditur me shkelma në këmbë e grushte në fytyrë të dëmtuarin D.I.. Tutje ka shtuar se gjendje faktike më së miri shihet nga video incizimet e paraqitura ku shihet se i mbrojturi im ndal veturën dhe menjëherë, shumë pranë derës së veturës së tij ndalet vetura e Policisë së Kosovës, të cilët zbresin nga vetura dhe tentojnë t'a hapin me forcë derën e veturës së të pandehurit dhe në atë mënyrë nga forca e tërheqjes e godasin vet veturën e policisë, dhe posa arrijnë t'a hapin derën , i pandehuri duke tentuar që të dalë vet nga vetura, pa asnjë rezistencë apo sjellje që do të pengonte zyrtarët policor që t'a prangosnin, shihet se si dy zyrtarët policor e tërheqin nga vetura të mbrojturin tim dhe në momentin që ai gjendet në këmbë njëri nga zyrtarët policor në mënyrë të ashpër e çnjerëzore e tërheq nga krahu, e shtrin për toke, nga ku fillojnë t'a godasin me grushte e shqelma. Pra siç edhe shihet i mbrojturi im nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të zyrtarëve policor, nuk ka rezistuar ndaj dhunës së tyre dhe nuk i është

kundërpërgjigjur me asnjë veprim dunës së zyrtarëve policor të ushtruar ndaj tij. Andaj, mbi bazën e të gjitha këtyre, i ka propozuar gjykatës që për këtë veprës të pandehurin t'a liroj nga akuza. Lidhur me veprën penale sipas pikës I të aktakuzës, për të cilën i pandehuri e ka pranuar fajësinë i ka propozuar gjykatës që të njëjtit t'i shqiptoj një dënim sa më të butë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, si pranimi i fajësisë në shqyrtim fillestar, nuk ka të kaluar kriminale, nuk ka qenë asnjëherë i përfshirë në kryerjen e ndonjë vepre penale, dhe se është hera e parë që përballat me drejtësinë, ka qenë bashkëpunues me organet e ndjekjes, është penduar dhe ka kërkuar falje për veprimet e ndërmarra, është mbajtës i familjes, nga puna e tij varet edhe pjesa tjetër e familjes sepse i njëjti është i vetmi në familje që punon dhe kujdeset financiarisht për të ta.

I pandehuri i parë E.R. në fjalën hyrëse dhe atë përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë deklarin e mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të pandehurit të dytë Av. Naser Azemi në fjalën hyrëse ka deklaruar se e kundërshtojmë në tërësi aktakuzën e PTHM, sa i përket të mbrojturit tim, kjo për faktin se prokuroria nuk ka arritur që të vërtetojë përtej dyshimit të bazuar mirë se i mbrojturi im ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në pikën II të dispozitivit të aktakuzës, kjo për faktin se pretendimet e prokurorisë se i mbrojturi im ka tentuar ta sulmojë zyrtarin policor R.K., për të njëjtën nuk ka kurrfarë ekspertize mjeko ligjore me të cilën do të vërtetoheshin pretendimet e prokurorisë, ne vlerësojmë se i mbrojturi im pas administrimit të të gjitha provave do të shpallet i pafajshëm.

I njëjti në fjalën përfundimtare të cilën e ka dorëzuar me shkrim ndër të tjera ka theksuar, se aktakuza e Prokurorisë Themelore Mitrovicë nuk është e mbështetur me as edhe një provë të vetme direkte apo indirekte, qoftë personale apo materiale me të cilën do të vërtetohet se i mbrojturi im ka kryer veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402, par.4, lidhur me par. 2 dhe 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që për të mbrojturin e tij të nxjerr aktgjykim lirues, në mungesë të provave.

I pandehuri i dytë I.SH. në fjalën hyrëse dhe atë përfundimtare ka deklaruar se e mbështet deklarin e mbrojtësit të tij.

Provat e administruara

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, me vëmendje të plotë, përkushtim profesional dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të pandehurve, si dhe faktet në favor të tyre duke iu mundësuar të pandehurve, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të tyre, ashtu që gjatë shqyrtimit gjyqësor bëri administrimin e këtyre provave:

Provat personale

Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar i dëmtuari D.I. i cili ndër të tjera ka deklaruar “...në momentin që ne kemi arritur ta ndalojë, me derën e automjetit ka goditur automjetin tonë, shoferi E.R., i ka shkaktuar edhe dëme automjetit të policisë, por unë nuk e di a është bërë ndonjë foto e dëmit. Më pas unë kam dalë nga automjeti së bashku me rreshterin B.A., dhe pastaj e kam kapur shoferin e automjetit për të vënë në kontroll, gjatë tërheqjes ka qenë shumë rezistues me c ‘rast më ka goditur në fytyrë dhe gjatë gjithë kohës më ka goditur edhe me shqelma, por kemi arritur ta vëmë në kontroll, e kemi prangosur unë dhe rreshteri Baki, kanë ardhur në asistencë edhe nga Stacioni Policor në Vushtrri.” Tutje ka shtuar se i pandehuri i parë ka qenë shumë rezistues, se i kujtohet se është goditur nga i pandehuri i parë në anën e djathtë të fytyrës, nuk i kujtohet saktë se me çfarë por me siguri se me grusht. Sa i përket të pandehurit të dytë i njëjti ka deklaruar se nuk e di se cilat kanë qenë veprimet e tij sepse nuk e ka parë. Mbrojtësi i të pandehurit të parë lidhur me deklarin e të dëmtuarit se a është e vërtetë se i njëjti ka deklaruar “tutje e njëjta veturë kishte hyrë në rrugën “M.B.”, ku e kishte hapur derën duke goditur veturën e policisë, ndërkohë ai së bashku me kolegun B.A. kishin dalë nga vetura, më pas nga vetura kishte dalë i pandehuri E.R. i cili e kishte goditur me shqelm në këmbën e djathtë dhe me boks në syrin e djathtë”, dëshmitari është përgjigjur se ‘po’, ku pas shikimit të video incizimit nga vendi i ngjarjes, dhe pas kërkesës për të treguar momentin e goditjes nga i pandehuri i parë dëshmitari ka deklaruar “Kur e kam nxjerrë nga vetura ka qenë agresiv dhe e kam cekur edhe në raport”

Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar i dëmtuari R.K. i cili ndër të tjera ka deklaruar “Kemi qenë bashkë me rreshterin B.A., F.C.n, D.I.n dhe F.V.. Pasi kemi arritur ta lokalizojmë veturën, unë kam shkuar kah pjesa e pasagjerit të veturës mercedes, dhe jam afruar afër derës, jam afruar shumë dhe personi që ka qenë në anën e pasagjerit e ka hapur derën, vetë pasagjeri, edhe pse unë kam dashur ta hap derën dhe i njëjti e ka pasur një shishe të birrës në dorë, dhe të njëjtit ia kam mbajtur dorën në të cilën e ka pasur shihen, dhe në atë moment ka ardhur edhe kolegu im F.V., e i cili e ka kapur për dorës tjetër, jemi munduar të vendosim në kontroll, duke i dhënë urdhra, dhe në momentin që ka dalë nga vetura ia kam kapur dorën dhe ia kam vënë në kontroll atë dorë, ndërsa kolegu im dorën tjetër dhe kemi tentuar të ia vendosim prangat, i njëjti vetëm ka rezistuar por nuk më ka goditur, i kemi dhënë urdhër për tu shtrirë në tokë, i njëjti nuk e ka përfillur urdhrin, derisa jam detyruar të përdori goditje çorientuese, i njëjti mua nuk më ka goditur.” Tutje ka shtuar se nuk ka parë dhe nuk i ka vërejtur kolegët e tij derisa kanë qenë duke e prangosur të pandehurin E.R.. Tutje ka shtuar se të njëjtit ka mundësi që e kanë goditur veturën e Policisë me derë të automjetit të tyre, por nuk mund të them këtë me siguri. I njëjti ka shtuar se është ndjerë i rrezikuar nga i pandehuri i dytë pasi që i njëjti ka pasur një shishe në dorë dhe ka vlerësuar se i pandehuri i dytë ka dashur që t’a godas prandaj edhe ja ka kapur dorën, pasi që i njëjti përkundër urdhrave për t’a lëshuar shihen, ai nuk ka vepruar. Dëshmitari – i dëmtuari ka shtuar se nuk ka pësuar lëndime. Në pyetjen e gjykatës se “a ju ka goditur juve i pandehuri i dytë në këmbë” i njëjti është përgjigjur “i pandehuri i dytë ka pasur dy duart nën kontroll, por gjatë lëvizjes me këmbë ka bërë rezistencë, por nuk mund t’a quaj se i njëjti më ka goditur...”

Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar B.A., i cili ndër të tjera ka deklaruar “Kam qenë në telefon, pasi që kam përgjegjësi si rreshter, me stacionin e Vushtrrisë, sepse rrethanat kanë ndryshuar nga momenti në moment, i kam informuar për veprimet që duhet ndërmarrë, kam qenë ulur në

pjesën mbrapa të veturës, dhe kur kam dalë nga vetura polici Dardani po përpiqej që ta arrestojë shoferin, të pandehurin Eroll, aty i kam ndihmuar edhe unë derisa e kemi prangosur, pasi që ka qenë e pamundur vetëm Dardani ta prangosë.” Lidhur me veprimet e të pandehurit të parë i njëjti ka deklaruar se “Rezistenca e Erollit ka qenë aktive për të pamundësuar prangosjen dhe gjatë kësaj ka gjuajtur me shqelma dhe unë e kam parë kur e goditur Dardanin me shqelma, dhe në kokë dhe atëherë unë iu kam gjuajtur në trup, duke ia marrë dorën e djathtë deri sa e kemi vënë nën kontroll, pasi që e kemi vënë në kontroll kanë ardhur edhe asistenca dhe ne ia kemi dorëzuar atyre. Ka pasur fjalë fyese nga të dy dhe e lidhshin me Serbi, por nuk më kujtohet se na janë kanosur.”. Tutje ka shtuar se e ka parë kur i pandehuri i parë e ka goditur Dardanin. Ndërsa pas shikimit të video incizimit, kur i është kërkuar të tregoj momentin kur është goditur D.I., dëshmitari është përgjigjur “Momenti është kur ne jemi munduar ta prangosim”. Lidhur me të pandehurin e dytë, dëshmitari ka deklaruar se nga prangosja i njëjti ka ofenduar zyrtarët policor, por nuk ka parë ndonjë veprim tjetër.

Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar F.V., i cili ndër të tjera ka deklaruar “...me pas në një rrugë te ngushtë kemi arritur që ta ndalojmë, ku të njëjtit veturën e policisë e kane goditur me veturën e tyre me rastin e takimit përballë respektivisht na kane goditur me qoshin e veturës-paralelisht ... dhe ne momentin që jemi ndalur kemi dal nga vetura, unë se bashku me kolegun Rilindin kem dal nga ana e djathtë menjëherë tek pasagjeret, pasi që kane qenë dy persona, ne atë moment jemi ofruar afër derës, personi pasagjer e ka hapur derën dhe ka dal, në dorë pasi që kane qenë nën ndikim të alkoolit e ka pasur edhe një shishe te qelqit ne dorë. Për një moment unë si zyrtar policor në atë rast kam kujtuar që i njëjti do te tentoj te godas kolegun tim, dhe i a kam kapur dorën dhe se bashku me Rilindin e kemi vënë në kontroll dhe i kemi vendosur prangat, i njëjti ka qenë agresiv por nuk na ka goditur.” Në lidhje me atë nëse i pandehuri i dytë ka tentuar t’a godas të dëmtuarin R.K., i njëjti ka deklaruar “dorën e ka ngritur larte por nuk e di nëse qëllimi i tij ka qenë për te goditur apo jo, nuk mund ta them që ka dashur te godas.”. Tutje i njëjti ka deklaruar se nuk i kujtohet se i pandehuri i dytë e ka shqelmuar, por kur i është kujtuar deklarata e dhënë në polici “i njëjti ka qenë shumë agresiv dhe ne momentin kur e kemi arrestuar ai na ka shqelmuar vazhdimisht “ ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici. Tutje ka deklaruar se “...nuk e kam parë se i pandehuri Eroll e ka goditur kolegun tim Dardan.” “...por i njëjti gjate bisedës e sipër na ka treguar që gjate arrestimit se i pandehuri e ka goditur, me sa me duket.” Tutje ka shtuar se nuk i kujtohet nëse e ka dërguar të dëmtuarin R.K. për tretman mjekësor, por kur i është kujtuar deklarata e dhënë në polici ku ka deklaruar “po kolegu Dardani ka qenë i goditur ne fytyrë në anenë djathtë dhe në këmbë, unë e kam dërguar për tretman mjekësor ne emergjencën e Vushtrrisë së bashku me Rilindin..” i njëjti ka deklaruar se qëndron pranë kësaj deklarate. Lidhur me deklarimin e goditjes së veturës së policisë nga vetura e të pandehurit, i njëjti ka deklaruar se “goditja ka ndodhur kur është hapur dera e veturës së të dyshuarit”. Në pyetjen e gjykatës se “ju me herët gjate këtij shqyrtimi keni deklaruar se unë kam kujtuar se i njëjti do ta godas – po tenton ta godas kolegun tim, ndërsa ne deklaratën që keni dhënë në polici ju keni thënë se i njëjti është vërsulur për t’a goditur, a na tregoni se vila është e vërtetë?”, i njëjti ka deklaruar se e vërtetë është deklarata që kam dhënë në fazën e hetimeve, ndërsa në pyetjen e gjykatës se “a ju ka sulmuar i njëjti?”, i njëjti ka deklaruar “nuk mund te them se me ka sulmuar”.

Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar F.C., i cili ndër të tjera ka deklaruar “kur ka hyre ne rrugën kur kemi arritur me u ndal, i njëjti nuk ka pasur hapësirë për te vazhduar sepse ka qene një muri dhe një automjet. I njëjti e ka ndalur automjetin dhe me pas ne jemi ofruar, ne anën e majtë kam qenë unë e nen anën e djathte i pandehuri. Fillimisht kolegu im Dardan dhe Baki janë marr me Erollin ndërsa Fisniku me Rilindin janë marr me të pandehurin Irfan. Kur kam dal unë nga automjeti, ne kemi pasur një informate se te njëjtit janë serb, dhe kane pasur regjistrim te veturës 01, po flas se ka ndodhur pas ngjarjes se Banjskes, me vone kur kam dalur i kam dëgjuar duke folur shqip, duke sharë dhe Fisniku me Rilindin gjate arrestimit te Irfanit, unë e kam pare që i njëjti e ka pasur një shishe te qelqit, po ashtu ka pasur shishe te birrave ne automjet, madje i pandehuri Eroll ka qene ne gjendje shume te dehur. Krejt ne fund unë kam shkuar dhe e kam pare që edhe i pandehuri Eroll ka qenë i prangosur, dhe ne fund kane ardhur patrulla e policisë se Vushtrrisë.” Tutje ka deklaruar se i pandehuri i parë e ka goditur të dëmtuarin D.I.. Poashtu ka shtuar se i njëjti nuk ka qenë i sulmuar, ndërsa i pandehuri i dytë nuk më ka sulmuar as dëshmitarin dhe as kolegët e tij. Në pyetjen e gjykatës se “ju ne deklaratën e dhënë ne polici keni thënë se “ i pandehuri Eroll ne cilësinë e vozitësit e ka goditur veturën e policisë,” ndërsa sot keni deklaruar se koleget e mije me kane treguar se i njëjti e ka goditur veturën e policisë, a mund te na tregoni se si është e vërteta?”, i njëjti është përgjigjur “jo unë nuk kam mundur t’a shoh sepse kam qenë shofer i veturës së policisë.”

Provat materiale

Procesverbali mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit - dëshmitarit D.I., i datës 18.10.2023, në të cilin ka deklaruar se pas marrjes së tretmanit mjekësor ka përpiluar raportin e policit ku ka përkthyer ngjarjen në tërësi dhe ka deklaruar se qëndron prapa atij raporti dhe se nuk ka asgjë për të shtuar.

Procesverbali mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit - dëshmitarit R.K., i datës 18.10.2023, ku ndër të tjera ka deklaruar “... në rrugën “M.B.” ku është bllokuar. Në momentin që automjeti Mercedes është ndalur ne jemi afuar me veturën tonë shoferi ka hapur derën e veturës së tij dhe e ka goditur veturën e policës me targa Police-180-04. Ne të gjithë kemi dal nga vetura zyrtare dhe i’u kemi afuar automjetit Mercedes me kujdes. Në automjet ndodheshin dy persona të cilët kanë dal nga automjeti, unë i kam dhënë pasagjerit urdhër me zë të lartë të ndaloj dhe t’a lëshoj shishen nga dora, pasagjeri përkundrazi është afuar në drejtim timin dhe ka ngritur dorën e djathtë ku e kishte birrën dhe ka provuar që të më godas, kolegu im Fisniku e ka parandaluar duke e kapur për dore, pastaj kolegu Fatoni, unë dhe Fisniku kemi arritur që të njëjtin t’a fusim në kontroll duke e prangosur. Gjatë krejt kohës pasagjeri, edhe pse i prangosur na ka fyer, na ka sharë duke na thënë “jeni ba si shkijet” si dhe vazhdimisht ka tentuar të na godas me këmbë...edhe drejtuesi i automjetit i ka rezistuar kolegët Dardanin dhe Bakiun, por fatmirësisht edhe ata e kanë futur situatën në kontroll duke e prangosur.” Po ashtu ka shtuar se kolegu Dardan ka qenë i goditur në fytyrë në anën e djathtë dhe në këmbë, dhe si ky e ka dërguar për tretman mjekësor në emergjencën e Vushtrrisë.

Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit B.A. , i datës 18.10.2023 në të cilin ndër të tjera ka deklaruar se përderisa kanë qenë në ndjekje të automjetit ku kanë qenë të dyshuarit, i

njëjti është futur në rrugën “M.B.” dhe është bllokuar, pastaj të gjithë zyrtarët policor kanë dal nga automjeti/ Tutje ka shtuar se “Në automjet ndodheshin dy persona të cilët kanë dal nga automjeti, unë i kam thënë shoferit të ndalet dhe i kam thënë se je i arrestuar dhe duke i’u afruar ai me shkelm e ka goditur policin D.I. dhe më pas edhe me boks në fytyrë dhe duke tentuar të më godas me këmbën e djathtë ne e kemi shtri për toke dhe e kemi prangosur. I njëjti ka qenë shumë agresiv duke na sharë dhe duke na thënë “çka keni, jeni ba ma të zi se shkijet, do ta shihni se çka kam me ju ba”. Duke e ngritë në këmbë e kam vërejtë se edhe kolegët e tjerë po e prangosnin edhe pasagjerin, i cili poashtu ka qenë agresivë dhe nga dora e ka lëshu një shishe të qelqit me birra.”.

Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit F.V., i datës 18.10.2023 ku ndër të tjera ka deklaruar “...në rrugën “M.B.” vetura në fjalë është bllokuar sepse nuk ka pasur dalje dhe posa ne jemi afruar me veturën tonë, shofer ka hapur derën e veturës dhe e ka goditur veturën e policisë me targa Police-180-04. Ne të gjithë kemi dal nga vetura zyrtare...Personave në fjalë i’u kemi dhënë urdhra verbal, të njëjtit kanë refuzuar dhe nuk i’u kanë bindur urdhrave duke bërëtitur dhe duke sharë e duke na thënë “kokit bo si shkijet”, gjithashtu kanë qenë shumë agresiv. Unë personalisht së bashku me kolegun Rilindin kemi dal në anën kah pasagjeri ku i njëjti ka pasur në dorë një shishe të birrës qelqi ku me të cilën i është vërsul kolegut Rilindit për t’a goditur, ku unë ja kam bllokuar dorën dhe me atë shishe është vet goditur në fytyrën e tij, i njëjti ka qenë shumë agresiv dhe në momentin kur e kemi arrestuar ai na ka shkëlmuar vazhdimisht.”

Raporti policor nga zyrtari D.I. i datës 07.10.2023, në të cilin ndër të tjera është theksuar “...Pastaj ka vazhdo në rrugën “M.B.” ku edhe e ka hapur derën duke na e goditë automjetin e policisë me targa Police-180-04. Unë dhe rreshter B.A. që ishim ulur në të djathtë kemi dal, nga automjeti Mercedes ka dal shoferi (E.R.) i cili më ka goditë me shqelma në këmbën e djathtë dhe me boksin e dorës së djathtë më ka goditë në fytyrë nën dytin e djathtë, me këmbë (shqelma) ka tentuar t’a godas rreshterin mirëpo ne e kemi shti nën kontroll duke e shtri në tokë dhe e kemi arrestuar (prangosur). I njëjti gjatë arrestimit ka qenë shumë agresiv duke na sharë dhe duke na thënë “largohuni çka jeni ba ma të zi se shkiet, keni me pa çka kam me ju ba juve” Po ashtu edhe pasagjeri (I.SH.) që ka qenë me të është arrestuar nga kolegët tjerë pasi që sapo ka dal nga vetura ka tentuar t’i ndihmoj... Si pasoj e goditjes më është ënjtur fytyra dhe kolegët më kanë dërguar në Spitalin e Vushtrrisë ku edhe jam trajtuar nga mjekët dhe jam liruar për shërim në shtëpi.”

Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit H.H., i datës 07.10.2023, i cili ka deklaruar se me datën 07.10.2023, rreth orë 18:00 ka qenë me veturën e tij në rrugën “Haxhi Zeka”, në drejtim të rrugës “Skënderbeu”, kur një veturë me shpejtësi të madhe vinte përball të njëjtit me ç’rast e ka goditur në anën e majtë prapa të veturës së tij, dhe pastaj ka parë edhe një veturë të policisë që ishte në ndjekje të veturës e cila e ka goditur të njëjtin. Tutje ka deklaruar se nuk ka pësuar lëndime.

Raportet mjekësore me nr. të protokollit me nr.11299, të datës 07.10.2023 të lëshuar nga Qendra Emergjente në Vushtri, në të cilat shihet se i dëmtuari D.I., ka pranuar tretman mjekësor në këtë spital.

Lexohet ekspertiza mjekoligjore e datës 13.10.2023, në të cilën është konstatuar se i dëmtuari D.I. ka pësuar Dëmtime të lehta trupore.

Procesverbali mbi matjen e alkoolit- testit i datës 07.10.2023, në të cilin evidentohet se i pandehuri i parë E.R. me datën 07.10.2023, në ora 19:31 ka qenë nën ndikimin e alkoolit me vlerë prej 0.75mg/L.

Informacionet mbi te kaluarën kriminale ne emër te te pandehurve, nga të cilat shihet, se të pandehurit, me përjashtim të rastit që është në shqyrtim tani dhe kundërvajtjeve në trafik, nuk kanë të kaluar tjetër kriminal, nuk kanë vendime të formës së prerë, me të cilat janë shpallur fajtor për kryerjen e ndonjë vepre penale.

Foto dokumentacioni ku shihet automjeti i të pandehurit, si dhe shihen lëndimet në fytyrë të të dëmtuarit D.I.

Në video incizimi në CD ku shihet momenti i ndaljes së automjetit, ku katër zyrtarët policor dalin nga automjeti i tyre, ndërsa të pandehurit nuk lëvizin, përderisa zyrtarët policor hapin derën e vozitësit të automjetit të të pandehurit të parë, automjeti i policisë lëvizë para, dhe i pandehuri i parë nxjerrët nga automjeti, ku në atë rast i pandehuri i parë nuk shihet se bënë ndonjë lëvizje, vërsulje apo goditje në drejtim të ndonjërit nga zyrtarët policor, e i cili pastaj tërhiqet ashpër nga zyrtari policor dhe pastaj shihet se me gjasë i njëjti është rrëzuar në tokë ku në të njëjtën kohë zyrtari policor, i pesti, del nga automjeti vrapon afër vendit ku është (me gjasë i shtrirë) i pandehuri i parë, dhe nuk ndalet fare aty, por vrapon në anën tjetër, ku veçse zyrtari tjetër policor e nxjerr me forcë nga automjeti të pandehurin e dytë, i cili nuk shihet se ka ndonjë gjësend në dorë, dhe nuk shihet ndonjë veprim, vërsulje, ngritje e dorës apo goditje në drejtim të zyrtarëve policor, ku zyrtari që e nxjerr nga automjeti e tërheq për disa hapa dhe fillon t'a sulmoj të pandehurin e dytë, dhe këtij sulmi i bashkëngjitet e zyrtari i pestë policor (që del i fundit nga automjeti) i cili sulm shihet se vazhdon për disa sekonda derisa i pandehuri i dytë shihet duke u rrëzuar në tokë.

Procesverbali mbi intervistimin e te pandehurit E.R. i datës 07.10.2023, i datës 08.10.2023 dhe procesverbali mbi marrjen ne pyetje në procedure paraprake e datës 18.10.2023, ku me datën 07.10.2023 nuk është intervistuar për shkak që ka qenë në gjendje të dehur, ndërsa me datën 08.10.2023 i njëjti ka mohuar t'a ketë goditur automjetin e policisë me derën e automjetit të tij, po ashtu ka mohuar të ketë goditur, kanosur apo fyer ndonjërin prej zyrtarëve policor. Ka pohuar se shkak kryesor i ardhjes deri në atë situatë ka qenë konsumi i alkoolit. Ndërsa gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake, me datën 18.10.2023 ndër të tjera ka deklaruar se atë ditë ka qenë nën ndikimin e alkoolit pasi ka konsumuar 4-5 birra për një kohë shumë të shkurt, i njëjti ka deklaruar se nuk i kujtohet shumë nga ajo ditë, por me të parë rotacionin nga policia i njëjti është ndal, pas urdhrave për të dal nga automjeti i njëjti ka dal, është arrestuar dhe është futur në automjetin e policisë, ku është dërguar në SP në Vushtrri, ku gjatë rrugës deri në SP, është goditur

nga 2 apo tre zyrtar ku edhe nga goditjet e marra ka përdorur terapi. I njëjti kategorikisht ka mohuar të ketë sulmuar ndonjërin nga zyrtarët policor.

Procesverbali mbi intervistimin e te pandehurit I.SH. ,i datës 07.10.2023, i datës 08.10.2023 dhe procesverbal mbi marrjen ne pyetje në procedure paraprake e datës 18.10.2023, ku me datën 07.10.2023 nuk është intervistuar për shkak që ka qenë në gjendje të dehur, ndërsa me datën 08.10.2023 i njëjti ka mohuar të ketë pasur shishe të qelqit në dorë, por që duke dal nga makina shishja që ka qenë tek këmbët ka rënë jashtë makinës, ka mohuar të ketë fyer apo sulmuar zyrtarët policor qoftë me shishe, me grushte apo shqelma. Tutje ka shtuar se nuk e ka parë të pandehurin e parë duke goditur ndonjë zyrtar policor, por që nuk e di se a ka rezistuar. Gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake me datën 18.10.2023 i njëjti ka deklaruar se gjatë kthimit nga Prishtina në drejtim të Vushtrisë, kur kemi arrit në Vushtri Erolli ka hyrë në tejkalim ku në kolon kishte qenë edhe policia, e të cilët pasi kanë vërejtur tejkalimin kanë ndezur dritat rotative dhe kanë bërë me shenjë që të ndalet automjeti, por i njëjti nuk e ka ndal, ka hyrë rrugicave, e cila vozitje ka zgjatë rreth 10 min, ku i njëjti ka kërkuar gjatë gjithë kohës nga i pandehuri i parë që t'a ndal automjetin, dhe kur ka hyrë në rrugën e F.B., kanë arritur policia, kanë hapur derën e pasagjerit, dhe një shishe e birrës që ka qenë në vendin e destinuar për shishe në derë të automjetit ka rënë nga automjeti, dhe me të dal nga automjeti policia më kanë arrestuar. I njëjti ka theksuar se nuk ka pasur shishe në dorë, nuk ka qenë në ndikimin e alkoolit sepse i di të gjitha veprimet etj. se në asnjë moment nuk ka sulmuar zyrtarët policor, dh as nuk i ka fyer, duke shtuar se është duke u mbajtur pa të drejtë.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet Faktet jokontestuese

- Është fakt jokontestues se i pandehuri i parë dhe i dytë në ditën kritike kanë qenë së bashku në veturë;
- Është fakt jokontestues se i pandehuri i parë, si drejtues i automjetit nuk është ndalur edhe pas shenjave nga policia që të ndalet;
- Është fakt jo kontestues se i pandehuri i parë, si drejtues i automjetit, gjatë kohës së drejtimit të automjetin ka qenë në ndikimin e alkoolit me 0.75mg/L.

Këto fakte nuk janë kontestuar nga palët (janë pohuar) dhe të njëjtat vërtetohen dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Faktet kontestuese

- Kontestuese ishte nëse të pandehuri me rastin e ndalimit të automjetit, gjatë arrestimit nga Policia e Kosovës kanë sulmuar zyrtarët policor D.I. dhe R.K..

I. Vendimi i gjykatës lidhur me pikën I të dispozitivit të aktgjykimi

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

I pandehuri i parë ka deklaruar se e pranon fajësinë sa i përket veprës penale të përshkruar në pikën I të dispozitivit të aktakuzës, duke shtuar se është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale dhe I ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do t'a përsërisë një vepër të tillë.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se pajtohen me pranimin e fajësisë nga i pandehuri i parë lidhur me veprën penale si në pikën I të aktakuzës, pasi që pranimi i fajësisë është bërë vullnetshëm, pas konsultimit me avokatin mbrojtës, i bazuar në prova materiale si në aktakuzës, ashtu që gjykatës i ka propozuar që pranimin e fajësisë nga i pandehuri t'a merr si rrethanë lehtësues, së bashku me rrethanat tjera.

Mbrojtësi i të pandehuri të parë ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pasi që pranimi është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, i bazuar edhe në prova dhe që nga momenti i parë që është arrestuar dhe pas deklarimit edhe në polici edhe në prokurori i njëjti ka shprehur keqardhje për veprimet e tij.

Vlerësimi i i gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën si *Procesverbali mbi matjen e alkoolit- testit i datës 07.10.2023 dhe Procesverbali mbi intervistimin e te pandehurit E.R. i datës 07.10.2023, i datës 08.10.2023 dhe procesverbali mbi marrjen ne pyetje në procedure paraprake e datës 18.10.2023.*

Gjendja faktike e vërtetuar sa i përket dispozitivi I të aktakuzës

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri Eroll Rshani. ka kryer veprën penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 371 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur “*Kushdo që drejton automjetin në gjendje të paaftë apo nën ndikim të alkoolit nëse në gjak ka alkool mbi 0,5 g/kg respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë apo të substancave tjera dehëse nëse shkaktohet aksident dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*”,

Koha e kaluar në paraburgim të pandehurit i është llogaritur me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ashtu siç parashihet me nenin 79 par 1 të KPRK-së, ku është përcaktuar se “*Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, në masën edukative institucionale dhe dënimin me gjobë*”.

Vendimin për ndalimin e drejtimit të automjetit gjykata e ka marrë bazuar në nenin 64 par 1 dhe par 2 të KPRK-së, ku është përcaktuar se “*Kryesit të veprës penale, i cili rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t'ia ndalojë drejtimin e automjetit të llojit apo të kategorisë së caktuar*”, ndërsa në paragrafin 2 është përcaktuar se “*Gjykata cakton kohëzgjatjen e dënimit të*

urdhëruar sipas paragrafit 1. të këtij neni, kohëzgjatja e të cilit nuk mund të jetë më e shkurtë se një (1) vit e as më e gjatë se pesë (5) vjet, duke llogaritur nga dita kur vendimi merr formën e prerë. Koha e kaluar në burg apo në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 38, 69 dhe 70 të KPRK-së, ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga i pandehuri, rrethanat personale, faktin se i njëjti punon dhe ka biznesin e tij, faktin se më parë nuk ka qenë i gjykuar, pastaj edhe pendimin e shprehur për kryerjen e kësaj vepre penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, ndërsa sa iu përket rrethanave rënduese gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit, është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me rrethanat e kryerjes së veprave, shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

Gjithashtu duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata ka vlerësuar se nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet dënim më i rëndë apo më i butë, dhe dënimi i shqiptuar është i domosdoshëm në mënyrë që të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së dhe atë që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjendja faktike e vërtetuar nga ana e gjykatës dhe vlerësimi i provave nga gjykata lidhur me pikën II të dispozitivit të aktgjykimit

Gjykata pas analizimit me kujdes të gjitha provave të lartcekura, veç e veç e në lidhshmëri me njëra tjetrën, ka ardhur në përfundim se nuk është vërtetuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale si në pikën II të dispozitivit të aktakuzës, për të cilën akuzohen, andaj të njëjtit i ka liruar nga aktakuza në bazë të nenit 363 par.1, pika 1.3 të KPPK-së, përkatësisht në mungesë të provave.

Prokuroria Themelore Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.1647/2023, të datës 23.10.2023, ndaj të pandehurve të cilët sipas pikës II të të njëjtës akuzohen se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.4, lidhur me par. 2 dhe 1 dhe nenin 31 të KPRK-së. Neni 402 par.4 i KPK-së përcakton se *“Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të gjyqtarit, prokurorit, policit, zyrtarit doganor, zyrtarit*

korrektues, ose përfshin kanosje për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.” Ashtu që elementet e posaçme të cilat ndërtojnë figurën e kësaj vepre penale janë:

1. Sulmi apo kanosja serioze se do të sulmohet polici
2. Sulmi të ketë rezultuar me lëndim të lehtë trupor
3. Kanosja për përdorim të armës apo mjetit tjetër të rrezikshëm

Andaj, pasi që gjatë shqyrtimit gjyqësor me provat e administruara materiale si dhe me deklaratat e dëshmitarëve nuk është arritur të vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën penale në fjalë.

Nga video incizimi, gjykata pa asnjë mëdyshje ka vërtetuar se i pandehuri i parë dhe i pandehuri i dytë nuk kanë ndërmarr asnjë veprim me qëllim të vërsuljes apo goditjes së zyrtarëve policor, të njëjtit nuk kanë pasur asnjë gjësend në dorë dhe nga momenti i ndaljes nuk kanë tentuar asnjëri që të ikin, apo t’i ndihmojnë njëri tjetrit, përkundrazi të njëjtit qetësisht kanë qëndruar në automjet derisa janë nxjerr nga zyrtarët policor, ku edhe shihet se si i pandehuri i dytë sulmohet nga së paku dy zyrtar policor.

Deklarimit të të dëmtuarit D.I. se i pandehuri në momentin e daljes nga automjeti, pasi që i dëmtuari e ka kapur dhe ka filluar tërheqjen e tij për ta vënë nën kontroll, i pandehuri e ka goditur në anën e djathtë të fytyrës, por që nuk i kujtohet saktësisht me çka, si dhe deklaramit se i pandehuri i dytë posa ka dal nga automjeti ka tentuar t’a ndihmojë të pandehurin e parë, gjykata nuk i’a fali besimin pasi që deklarimet e tij janë në kundërshtim me provat materiale që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, konkretisht me video incizimin ku shihet në tërësi momenti i arrestimit deri në shtrirjen në tokë të të pandehurit të parë, ku nga ky video incizim, siç është elaboruar edhe më lartë nuk shihet asnjë veprim i të pandehurit, pra asnjë goditje e të pandehurit në drejtim të të dëmtuarit, ndërsa nuk shihet as edhe një veprim i të pandehurit të dytë në drejtim të ndihmës së të pandehurit të parë, pasi që i njëjti shihet se qëndron në një vend, pran derës nga ana e pasagjerit të automjetit në të cilin ka qenë.

Deklarimit të dëshmitarit B.A. se i pandehuri i parë ka manifestuar rezistencë aktive gjatë prangosjes dhe gjatë kësaj e ka goditur tani të dëmtuarin me shqelma dhe në kokë, dhe deklarimit të tij në polici se i njëjti ka tentuar ta godas edhe dëshmitarin, Gjukata nuk i’a fali besimin pasi që deklarimet e dëshmitarit janë në kundërshtim me provat materiale të administruara, konkretisht video incizimit ku shihet në tërësi momenti i arrestimit deri në shtrirjen në tokë të të pandehurit të parë, ku nga ky video incizim, siç është elaboruar edhe më lartë nuk shihet asnjë veprim i të pandehurit, pra asnjë goditje e të pandehurit në drejtim të të dëmtuarit dhe as tentim i të njëjtit për t’a goditur dëshmitarin.

Deklarimit të të dëmtuarit R.K. në shqyrtim gjyqësor se i pandehuri dytë vetëm ka rezistuar gjatë arrestimit por nuk e ka goditur, nuk ka tentuar t’a godas, sepse të dy duart i ka pasur nën kontroll, i’a fali besimin, pasi që e njëjta deklaratë është në harmoni të plotë me provat tjera materiale, konkretisht, video incizimin në të cilin shihet se i pandehuri i dytë nuk ka ndërmarr asnjë veprim në drejtim të sulmit ndaj të dëmtuarit. Deklaratës së të dëmtuarit të dhënë në polici në të cilën ka

deklaruar se i pandehuri i dytë është afruar në drejtim të tij, duke e ngritur dorën djathtë në të cilën e ka pasur birrën në atë mënyrë që ka provuar ta godas të dëmtuarin, gjykata nuk i'a fali besimin pasi që e njëjta është kundërthënëse, në kundërshtim me deklarimin në shqyrtim gjyqësor si dhe me video incizimin e administruar ku shihen veprimet e të pandehurit të dytë, ashtu që shihet se i pandehuri nuk ka dorë të ngritur dhe nuk shihet asnjë përparim i të njëjtin në drejtim të të dëmtuarit.

Deklarimit të dëshmitarit F.V. në shqyrtim gjyqësor me deklarimin e dhënë në polici sipas vlerësimit të gjykatës kanë kundërthënie të konsiderueshme, ashtu që në deklarimin në shqyrtim ka deklaruar se i njëjti ka kujtuar se i pandehuri i dytë mund t'a godas të dëmtuarin R.K.n, por që nuk i ka goditur, ndonëse dorën në të cilën e ka pasur shishen e qelqit e ka ngritur lart, ndërsa në polici ka deklaruar se me shishen e qelqit që ka pasur në dorë, ië është vërsulur të dëmtuarit R.K.t, por që ky (dëshmitari) i'a ka bllokuar dorën, ndërsa gjatë arrestimit i pandehuri i ka shqelmuar vazhdimisht. Këto dy deklarime janë në kundërshtim të theksuar me njëra tjetrën, për më tepër deklarimi në polici si dhe pjesa e deklarimit në shqyrtim ku thekson i pandehuri i dytë e ka ngritur dorën lart në të cilën e ka pasur shishen e qelqit janë në kundërshtim me provat materiale, konkretisht video incizimin nga vendi i ngjarjes, në të cilin incizim nuk shihet asnjë vërsulje e as ngritje e dorës lart me shishe të qelqit nga i pandehuri i dytë, e as nuk shihet duke i shqelmuar zyrtarët policor (përfshirë të dëmtuarin R.K. dhe dëshmitarin).

Gjykata ka vlerësuar edhe deklarimin e dëshmitarit H.H.t dhe dëshmitarit F.C., por që të njëjtat deklarime nuk ndihmojnë në ndonjë mënyrë sqarimin dhe nuk kanë kontribut në zbardhjen e rrethanave në lidhje me rastin.

Gjykata ka ardhur në përfundim se deklarimet inkriminuese ndaj të pandehurve nga të dëmtuarit dhe dëshmitarit, si në shqyrtim gjyqësor ashtu edhe në fazat e mëparshme të procedurës janë kundërthënëse, të pambështetura dhe në kundërshtim me provat materiale, konkretisht me video incizimin, e cila provë sipas vlerësimit të gjykatës sqaron më së miri gjithë ngjarjen që nga ndalja e automjeteve e deri te shtrirja për toke e të dyshuarve, dhe ky video incizim në tërësi i demanton deklarimet inkriminuese ndaj të pandehurve të bërë nga zyrtarët policor.

Gjykata, thekson se as pretendimi i zyrtarëve policor se i pandehuri i parë me derën e automjetit të tij ka goditur automjetin e policisë, është po ashtu i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim me provat materiale, konkretisht video incizimin, pasi që nga video incizimi shihet se goditja e veturës së policisë ka ardhur nga hapja me forcë e derës së automjetit të të pandehurit të parë të bërë nga zyrtarët policor dhe jo nga i pandehuri.

Gjykata edhe njëherë rithekson se nuk është kontestues fakti i dëmtuari ka pësuar lëndim të lehtë trupor, dhe atë në fytyrë, por që gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se lëndimi i pësuar nga i dëmtuari është shkaktuar nga i pandehuri i parë siç pretendon i dëmtuari D.I..

Nga të gjitha këto, e duke pasur parasysh se prokuroria nuk ka arritur që t'a provoj përtej dyshimit të bazuar se të pandehurit E.R. dhe I.SH. kanë kryer veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar

nga neni 402 par.4, lidhur me par. 2 dhe 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, gjykata arriti në përfundim se të njëjtit duhet të lirohen nga akuza, andaj edhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës.

Vendimin për kërkesën pasurore juridike gjykata e ka marrë në bazë të nenit 460 par.1 të KPPKsë ku është përcaktuar se *“Personat e autorizuar mund të tërhiqen nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe atë ta realizojnë në kontest civil. Kur propozimi tërhiqet, i njëjti propozim nuk mund të paraqitet përsëri, përveç nëse me këtë Kod është paraparë ndryshe.”* pasi që të dëmtuarit kanë hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale për të pandehurin e parë, lidhur me pikën I të dispozitivit të aktgjykimi është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, si dhe nën par. 2.6 dhe 2.9 ku është përcaktuar se *“Shpenzimet e procedurës penale janë shpenzime të bëra gjatë procedurës penale dhe shpenzimet e shkaktuara lidhur me të. Shpenzimet e procedurës penale përfshijnë: shpenzimet paushalle dhe taksën për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit”* si dhe neni 452 par.1 të KPPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata e shpall të pandehurin fajtor, me aktgjykim vendos se detyrohet t’i kompensojë shpenzimet e procedurës penale.”*

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale për të pandehurin e dytë I.SH. lidhur me pikën II të dispozitivit të aktgjykimit është marrë në bazë të nenit 453 par. 1 të KPPK-së, ku përcaktohet se *“Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykimi me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449, paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore, përveç në rastet e caktuara në paragrafët vijues të këtij neni”*.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTERRI Departamenti i
Përgjithshëm – Divizioni Penal P.nr.292/23, datë: 30.01.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Agron Maxhuni

Numri i lëndës: 2023:226089
Datë: 30.01.2025
Numri i dokumentit: 06782432

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.